SUFAJ

REPUBLIKAESHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

Nr. 2000 Prot

Tiranë, më 18.02.2022

**M I R A T O I**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ADMIR ABRIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E DREJTËSISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE TIRANË

# PROGRAM VJETOR I TRAJNIMEVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TË BURGJEVE DHE PARABURGIMEVE

**Viti 2022**

## I. Vlerësimi i situatës ekzistuese:

Trajnimi i personelit të sistemit të burgjeve dhe paraburgimeve ka qenë dhe mbetet një prej prioriteteve kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për përmirsimin e shërbimit në sistemin e zbatimit të vendimeve penale me burgim.

- Në kushtet e kufizimit social dhe vështirësive të krijuara nga pandemia, Qendra e Trajnimit e mbështetur nga partner si KE, Ambasada Amerikane, OSCE ka alternuar trajnimin në terren me trajnimin online, trajnim distancë duke përciellë materiale trajnuese dhe modelin e përgjithësimeve pozitive dhe informimit rreth problematikave, me qëllim nxjerrjen e mësimeve, duke bërë të mundur përfshirjen në trajnime të më shumë se 32% të stafit të burgjeve (1408 punonjës).

Trajnimet e zhvilluara kanë qenë:

- Trainim bazë me për punonjësit e rinj, që janë shpallur fitues për të punuar në

- Ritrajnim të punonjësve të rinj, gjatë periudhës së provës si dhe trajnim në detyrë
- Trajnim lidhur me aftësimin e stafit që punon me të mitur.
- Trajnime lidhur me parandalimin e vetëvrasjeve dhe trajtimin e shëndetit mendor

Gjatë vitit 2019 me mbështejen e Ambasadës Britanike, është hartuar Plani Strategjik i zhvillimit të sistemit penitenciar për vitin 2019-2022, ku janë parashikuar objektiva konkrete për trajnimin e stafit, të cilat do të jenë pjesë e këtij plani.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë vitit 2021, ka bashkëpunuar me partnerë të jashtëm si KE, Ambasada Amerikane, OSCE, Akademia e Sigurisë, për zhvillimin trajnimve dhe procedurave të testimit të kandidatëve për punonjës të policisë së burgjeve dhe me projektin Suedez per rehabilitimin e të miturve.

**Struktura:**

Struktura aktuale e trajnimit të stafit të burgjeve, e ngritur me Urdhër Nr.43, datë 25.03.2021, të Kryeministrit, është e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e sistemit të burgjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka përfunduar studimin për strukturën organike dhe në këtë kuadër, ka parashikuar ngritjen e Qendrës së Trajnimit me staf mësimor të mjaftueshëm për përballimin e nevojave të trajnimit. Stafi i Qendrës së Trajnimit parashikohet të jetë 10 punonjës.

Referuar Planit Strategjik te Veprimit, do të trajnohen 10 trajnerë, të cilët do ti shtohen numrit të trajnerëve të cilët do të zhvillojnë trajnim kaskadë

Bazuar në VKM Nr.881, datë 28.10.2020 dhe Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme, trajnimet e punonjësve të policisë së burgjve, do të planifikohen të zhvillohen në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë.

**Vlerësimi i nevojave:**

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka në dispozicion afërsisht 4524 punonjës, nga të cilët 3650 me uniformë. Duke analizuar dinamikën e personelit rezulton se në vitin 2021, janë liruar 421punonjës, nga të cilët 288 punonjës të policisë dhe 133 punonjës civil. Duke parë dinamikën e personelit në 5 vitet e fundit, nevojat për rekrutim janë mesatarisht rreth 300 punonjës në vit.

- ✓ Punonjës të rinj të policisë, për trajnim bazë, llogariten në 300 pjesmarrës Trajnimi do të zhvillohet në një afat 6 javor.

- ✓ Punonjës të nivelit të mesëm të shërbimeve multidisiplinare që rekrutohen në sistem, llogariten në **120** pjesmarrës
- ✓ Me qëllim përmirësimin e nivelit ë mesëm të menaxhimit në sektorin e sigurisë, planifikohet rekrutimi dhe trajnimi i 35 punonjësve.
- ✓ Trajnimi në detyrë, do të ofrohet për të gjithë punonjësit e sigurisë, i organizuar nga DPB dhe nga institucionet, me objektiv 2 ditë rajnim, në vit për çdo punonjës.

**Ambjentet**

Qendra e Trajnimit ka në dispozicion tre salla në DPB, me 170 $m^2$, e mjaftueshme për trajnimin e 90 punonjësve gjithashtu në shumicën e IEVP-ve disponon ambjente trajnimi.
Të gjithë IEVP kanë në dispozicion ambjente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për trajnimin në detyrë si dhe trajnime në terren që kryhen nga ana e DPB.
Ambjentet e Qendrës së Trajnimit janë të pajisura më së miri me mjete mësimore për lehtësimin e trajnimit.
Mbetet e pazgjidhur çështja e akomodimit, pra e ambjenteve për fjetje dhe pushim.
Lidhur me këtë çështje deri në krijmin e kushteve nga ana e DPB, do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me Akademinë e Sigurisë.

**Programet dhe curlikulat**

Me Urdhër Nr.352, datë 01.06.2017, të Drejtorit të Përgjthshëm, janë miratuar programet e trajnimit si më poshtë:

- Programi i trajnimit bazë
- Programi i trajnimit të personelit që punon me të mitur në institucionet penale
- Programi i trajnimit për stafin e burgut të grave
- Programi i trajnimit të stafit të nivelit të mesëm dhe të lartë
- Programi i trajnimit për ngritje në gradë të punonjësve të policisë së burgjeve
- Programi i trajnimit të stafit në detyrë

Programet e trajnimit bazë të punonjësve të policisë së burgjeve, të stafit që punon me të mitur dhe me gratë, janë rishikuar nga ekspertë të K.E dhe specialist të DPB dhe janë përmirësuar në formë curlikule, ku përcaktohet qëllimi, objektivat e temave, metodat dhe vlerësimi.

**Modulet** janë hartuar në vitin 2009 dhe një pjesë janë rishikuar. Aktualisht janë të disponueshme manualet e trajnimit bazë, manual i trajnimit të punonjësve të nivelit të mesëm dhe të nivelit të lartë. Me mbështetjen e partnerëve jashtë sistemit, është hartuar manual për shëndetin mendor, për komunikimin, për stafin që punon me të mitur etj.
Me mbështetjen e ekspertëve të KE janë rishikuar dhe përmirësuar mbi 30 module të cilat do të publikohen së shpejti për të qenë të aksesueshme nga pjesmarrësit në trajnim.

**Stafi i trajnimeve:**

Drejtoria e Përgjithshme i ka ofruar trajnimet nëpërmjet stafit të emruar në shërbimin e trajnimeve dhe punonjësve të tjerë me eksperiencë dhe të çertifikuar si trajner, afërsisht 15 punonjës. Në prill të këtij viti 13 trajner do të trajnohen në Colorado dhe gjithashtu të gjithë trajnerët e qendrës do të trajnohen me ekspert të KE.

**Partneriteti:**

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për trajnimin e stafit ka bashkëpunuar me Ambasadën Amerikane K.E, OSCE, KSHH dhe me institucione shtetërore si Akademia e Sigurisë.

**Buxheti:**

Është e domosdoshme që të planifikohet një buxhet i mjaftueshëm, për mbështetjen e trajnimeve, në aspektin mësimor, për publikimin e moduleve dhe programeve, të mjeteve mësimore, të hapsirave dhe në aspektin e trajtimit të pjesëmarrësve, me ushqim dhe strehim, në rastet kur janë nga zona të largëta.
Një pjesë e buxhetit do të mbulohet nga zbatimi i projektit mbështetje horiozontale dhe një pjesë nga ana e buxhetit të shtetit dhe Ambasada Amerikane

- Buxheti për katering dhe pajisje llogaritet në 35 milion lek të reja
- Aktivitete të tjera si vlerësim të nevojave, hartim i metodologjisë, trajnim i trajnerëve do të mbulohen nga projekti.

## II. Baza ku mbështetet programi:

- Planin e Veprimit të Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve për vitin 2022.

- Plani Strategjik i zhvillimit të sistemit penitenciar 2019-2022
- Rekomandimet e bëra nga Avokati Popullit dhe organizatat e pavarura, për përmirësimin e shërbimeve të sigurisë dhe të trajtimit e riintegrimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve.
- Recomandimin (97) 12 dhe 2006 (2)të KE.
- Në analizën e bërë në gjithë sistemin e burgjeve dhe të paraburgimeve mbi problematikat dhe shqetësimet, gjendjen dhe nevojat për trajnimin dhe ritrajnim.

## III. Prioritetet dhe objektivat që do të arrihen gjatë vitit 2022

### A. Trajnimi i stafit:

1. Realizimi i trajnimeve bazë për stafin e rekrutuar për të shërbyer në sistemin e burgjeve dhe paraburgimit. Trajnimi do të zhvillohet në ambjentet e Akademisë së Sigurisë me trajner të përbashkët nga Drejtoria e Përgjitshme dhe Akademia, bazuar në VKM Nr.881, datë 28.10.2020 dhe Marrëveshjes ndërmjet dy ministrive dhe në ambjentet e Qendrës së Trajnimeve.
    a. Punonjës të rolit bazë, parashikohen rreth **300**
    b. Punonjës të rolit të mesëm parashikohen rreth 35

2. Trajnim i punonjësve të IEVP-ve, në ambjentin e punës. Trajnimi do të jetë një thellim dhe përforcim i njohurive, shprehive dhe aftësive të programit bazë.
3. Trajnimi i stafit të nivelit të mesëm dhe të lartë me synim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e drejtimit në institucione.
4. Trajnim për stafin që punon me grupe specifike në burgje, (të mitur, gra, persona me probleme të shëndetit mendor, me varësi nga substancat narkotike, të dënuar afatgjatë dhe të përjetshëm, duke bashkëpunuar me partner brenda dhe jashtë sistemit).

### B. Konsolidimi i Qendrës së Trajnimit

1. Hartimi I projektit dhe bashkëpunimi me donatorët për një qender te re trajnimi
2. Publikimi i 1000 kopje të moduleve në dy vëllime
3. Miratimi i strukturës organike të aftë dhe të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të trajnimeve.
4. Zbatimi i metodologjisë së trajnimeve me mbështetjen e KE

5. Menaxhimi i të dhenave dhe vlerësimi i nevojave për trajnim
6. Përmirësimi i supervizimit, mbështetjes dhe vlerësimit të punonjësve të rinj, gjatë periudhës së provës.

**C. Bashkëpunim me partnerët**

1. Bashkëpunim, shkëmbim eksperience dhe ndarje informacioni me antarët e EPTA (Akademia Europiane e Trajnimit të Stafit të Burgjeve)
   - Akademinë e Sigurisë të Policisë së Shtetit
   - Komisioni Europian
   - OSCE
   - Ambasadën e SHBA në Tiranë
   - Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj

**IV. Masat, detyrat dhe aktivitetet që do të organizohen për realizimin e çdo objektivi e prioriteti:**

| Nr. | Detyrat që do kryhen | Afati | E Kryen | E Kontrollon | Nr. i pjesëmarrësve |
|---|---|---|---|---|---|
| I. | **Trajnimet bazë** | | | | |
| 1. | Trajnim i punonjësve te rinj të rolit bazë. Zgjatja e dy muaj | Janar-Shkurt/ | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 65 |
| 1.1 | Trajnim i punonjësve te rinj të rolit bazë. Zgjatja e proramit në 3 muaj. | Shtator-tetor/ | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 150[1] |
| 1.3 | Trajnim i punonjësve të nivelit të mesëm, të | Gjashtëmujori parë | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 40[2] |

[1] Numri i pjesëmarrësve në trajnimin bazë, varet nga rekrutimet që do të zhvillohen. Ky trajnim mund te zhvillohet me parë, ose mund të shtyhet.
[2] Numri dhe periudha varen nga situata e rekrutimit

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | rekrutuar në sistem | | | | |
| 1.3 | Procedurat e rekrutimit | Sipas planifikimit të DPB | Sektori i Personelit Akademia e Sigurisë | Drejtori i Përgjithshëm | 200 |
| **II** | **Trajnim i punonjësve të IEVP-ve, në ambjentin e punës, të organizuara nga DPB** | | | | |
| 2.1 | Trajnim i avancuar i p.r.b që janë në periudhë prove.<br>Programi dyjavor | Mars-Prill 2022 | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 120 |
| 2.2 | Trajnim per parandalimin e radikalizmit | Shkurt Mars | Qendra e Trajnimit | Drejtori i Përgjithshëm | 60 |
| 2.4. | Trajnime në institucione, mbi temat e mëposhtëme: | Gjatë gjithë vitit | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 450 |
| 2.4.1 | - Parimet dhe rastet e përdorimit të forcës dhe parandalimi i dhunës<br>- Menaxhimi i incidenteve dhe konflikteve<br>- Parandalimi i vetëvrasjeve dhe monitorimi i personave me risk<br>- Hartimi i rregjistrit të riskut të IEVP-ve<br>- Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm<br>- Aftësimi i punonjësve operator, për shërbimet e monitorimit dhe të paisjeve të kontrollit (skaner, dedektor,m pasqyra etj)<br>- Trajnim mbi formatet e vlerësimit të riskut, për arratisje, sigurinë dhe rendin, rishkeljen, rrezikun ndaj komunitetit.<br>- Trajnim për trajner<br>- Trajnim mbi situatat emergjente<br>- Trajnimi i stafit me uniformë mbi standartet profesionale të sjelljes dhe rregullat e komunikimit<br>- Trajnime të planifikuara në përgjigje të rekomandimeve dhe problematikave | | | | Staf i nivelit bazë dhe të mesëm me uniformë<br>Staf i drejtimit dhe menaxhimit<br>Operator dhe kontrollor<br>Stafi i Institucioneve per te mitur<br>Staf multidisiplinar<br>Staf i sigursë<br>Staf drejtues dhe i menaxhimit |
| 2.5 | - Testim për vlerësimin e përformancës dhe të nevojave për trajnime të punonjësve të grupeve të shoqërimit dhe të sigurisë.<br>- Testim i punonjësve që kanë aplikuar për ngritie në gradë | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.6 | Trajnim për gradën Inspektor | Maj | Drejtoria e Policisë | Drejtori i Përgjithshëm | 120 |
| 2.7 | Trajnim për gradën Kryeinspektor | Qershor | Drejtoria e Policisë | Drejtori i Përgjithshëm | 20 |
| **III** | **Realizimi i trajnimeve të stafit të nivelit të mesëm dhe të lartë me synim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e drejtimit në institucione. (Programi ndodhet bashkelidhur)** | | | | |
| 3.1 | Trajnim i drejtuesve të IEVP-ve per lidershipin | Prill | Inst.Correk Kolorado | Drejtori i Përgjithshëm | 13 |
| 3.1.1 | Trajnim per RIS | Mars Maj | Q.Trajnimit | | 120 |
| 3.1.2 | Trajnim Menaxhimin | Gusht | Inst.Correk Kolorado | | 14 |
| 3.2 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi Udhëzuesit administrativ | Qershor. | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 25 |
| 3.3 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi Udhëzuesit administrativ IEVP Shkodër, Peqin, Fier, Berat | Mars | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 30 |
| 3.4 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi menaxhimin IEVP Fier Berat Vlorë, Tepelenë | Shtator | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 25 |
| 3.5 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi menaxhimin IEVP Peqin, Lushnjë, Rrogozhinë | Tetor | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 25 |
| 3.6 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi menaxhimin IEVP Ali Demi | Gjashtëmujori i dytë | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 15 |
| 3.7 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi menaxhimin IEVP F.Krujë, Krujë, Lezhë, Burrel | Gjashtëmujori i dytë | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 25 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3.8 | Trajnim i ekipeve multidisiplinare mbi menaxhimin IEVP Korçë | Tetor | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 15 |
| **IV** | **Trajnime në bashkëpunim me partnerë jashtë sistemit** | | | | |
| 4.1 | Trajnim në bashkëpunim me K.Hollandez Helsinkit, Metodologjia COPOSO | Gjatë vitit | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 20 |
| 4.2 | Trajnim me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, për trajtimin e të miturve | Gjatë vitit | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 20 |
| 4.3 | Trajnime me mbështetjen e KE, për çështje të<br>- radikalizimit,<br>- shëndetit mendor<br>- kodit të sjelljes<br>- parandalimit të korrupsionit | Gjatë vitit | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | 120[3] |
| **V** | **Ngritja e Qendrës së Trajnimit dhe mbështeja nga ana logjistike, për të krijuar kushtet normale të zhvillimit të mësimit dhe të trajtimit të pjesëmarrësve** | | | | |
| 5.1 | Miratimi i strukturës organike të Qendrës së Trajnimeve | Deri në Prill 2022 | Stafi i Trajnimeve | Drejtori i Përgjithshëm | Është hartuar drafti |
| 5.2 | Publikimi i manualeve | Gjashtëmujori parë | Zyra e KE Tirane | Drejtori i Përgjithshëm | |
| VI | **PLANI I TRAJNIMEVE TË PARASHIKUARA PËR TU ZHVILLUAR NË AKADEMI TË SIGURISË** | | | | |
| 6.1 | Trajnim bazë | Gjashtëmujori dytë | AS ne bashkëpunim me DPB | | 200 |
| 6.2 | Trajnim i punonjësve të nivelit të mesëm per ngritje në gradë | | AS ne bashkëpunim me DPB | | 60 |
| 6.3 | | | | | |

[3] Ne total llogariten 1460 pjesemarres ne trajnime te zhvilluara vetem nga DPB, pa llogaritur trajnimet ne detyre nga stafi

MIRATOHET
DREJTORI I PERGJITHSHEM I BURGJEVE
ADMIR ABRIJA

QENDRA E TRAJNIMIT E DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE BURGJEVE TE

## PLANI I TRAJNIMEVE QE DO TE ZHVILLOHEN ME MBESHTETJEN E KE TETOR 2021 DERI NE TETOR 2022

PRIORITETET KRYESORE

| | Aktivitetet |
|---|---|
| | **Trajnim i punonjesve te vijes se pare (trajnim baze) I thelluar** |
| 1.1 | Trajnim mbi procedurat e reja (Trajnimi do te zhvillohet ne IEVP Shkoder |
| 1.2 | Trajnim mbi procedurat e reja (Trajnimi do te zhvillohet ne IEVP Korçe |
| 1.3 | Trajnim mbi procedurat e reja (Trajnimi do te zhvillohet ne IEVP Fier |
| 1.4 | Trajnim mbi procedurat e reja (Trajnimi do te zhvillohet ne IEVP Peqin |
| 1.5 | Trajnim mbi procedurat e reja (Trajnimi do te zhvillohet ne IEVP Berat |
| 1.6 | Trajnim mbi procedurat e menaxhimit te informacionit |
| | **Trajnim i stafit drejtues** |
| 2.1 | Trajnim mbi procedurat e menaxhimit te informacionit, drejtor. Trajnim online, nje dite |
| 2.2 | Trajnim mbi procedurat e menaxhimit te informacionit, shefat e policise. Trajnim online, nje dite |
| 2.3 | Trajnime per risite e akteve te reja ligjore dhe nenligjore Online Drejtuesit |
| 2.4 | Trajnim I drejtuesve per çeshtje te radikalizmit dhe ekstremizmit te dhunshem ne burgje |
| 2.5 | Trajnim mbi lidershipin e IEVP |
| 2.6 | Trajnim mbi procedura te vleresimit dhe kategorizimit |
| 2.7 | Trajnim nje mujor i punonjesve te rolit te mesem te policise qe do te rekrutohen ne muajin shtator |
| | **Trajnim per metodologjine (ToT** |
| 3.1 | Trajnim Trajneresh per rolin baze |
| 3.2 | Trajnim Trajnersh per shendetin mendor |
| 3.3 | Trajnim Trajneresh per vleresimin e riskut |

Schedule columns (weeks): Tetor 2021 (1–5), Nentor 2021 (1–4), Dhjetor 2021 (1–4), Janar 2022 (1–5), Shkurt 2022 (1–4), Mars 2022 (1–4), Prill 2022 (1–4), Maj 2022 (1–4), Qershor 2022 (1–4), Korrik 2022 (1–5), Shtator 2022 (1–4), Tetor 2022 (1–4)

Hartoi: Dreitues Femi SUFAJ